

PROCESVERBAL
nga seanca e 2-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 07.07.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Viktor Pavlovski.

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Emilija Janevska, Magdalena Dovleva Davidovska, Goran Radunović, Vesna Simonovska, Maja Damevska, Jeton Ismaili.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski hapi seancën e 2-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 11:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 05.06.2025.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga Seanca Konstitutive e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 03.07.2025.
3. Propozim për ribalancin e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025 me Propozim-vendim.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit ALTRA-SAT 2000 SHPKNJP Ohër, për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, për shkelje të nenit 50, paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV studio TERA Mangovski Zoran Manastir SHPKNJP, për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Ditët e Arsimit Mediatik 2025.
8. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Licencë Firewall.
9. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Çertifikata digjitale.
10. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Hulumtim – Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyrës së prezantimit dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve.
11. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 23-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 05.06.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të Seancës Konstitutive të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 03.07.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi propozimin për ribalancin e Planit Financiar për vitin 2025. Ai theksoi se shpenzimet totale të planifikuara sipas planit do të mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, përkatësisht arrijnë deri në 202.429.722,00 denarë. Me ndryshimet e propozuara, do të rishpërndahen 1.525.000,00 denarë, të cilët do të sigurohen nga kursimet e bëra në periudhën e kaluar. Këto mjete do të sigurohen duke zvogëluar disa pikë: 390.000,00 denarë do të zbriten nga pika për kompensim të shpenzimeve për punëtorët dhe qytetarët. Këto janë mjete që më parë janë shfrytëzuar për kompensim të ish-anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, 246.000,00 denarë do të zbriten nga pika për shërbime intelektuale dhe të tjera, 417.000,00 denarë do të zbriten nga pika për paga sepse revizori i brendshëm i Agjencisë në shkurt është zgjedhur në funksion tjetër shtetëror dhe që atëherë nuk i është dhënë paga. Me këtë automatikisht zvogëlohen dhe kontributet për sigurime shëndetësore, pensione dhe të tjera. Këto 1,525,000.00 denarë do të shfrytëzohen si në vijim: 515,000.00 denarë - për matjen elektronike të shikueshmërisë së reklamave politike me pagesë në televizionet kombëtare gjatë zgjedhjeve lokale në tetor 2025, 710.000,00 denarë - për njoftime në gazetatat ditore në gjuhën maqedonase dhe shqip (nëpërmjet furnizim të ri publik), 300.000,00 denarë - për qasje në platformën online që mundëson monitorim dhe përgatitje të raportit për publikime lidhur me ASHMA-në në internet portale, rrjete sociale, influencues, vlogerë dhe të ngjajshme, për periudhë prej 6 muajsh.

Z. Xhurovski kërkoi më detajisht shpjegim për pikën prej 300.000,00 denarësh, që është parashikuar për qasje në platformën për monitorim dhe përgatitjen e raporteve për mediat online, internet portalet dhe rrjetet sociale, me fokus tek influencuesit, vlogerët dhe krijuesit e përmbajtjeve, për periudhë prej gjashtë muajsh.

Z. Trajçevski theksoi se Agjencia nuk mund në mënyrë të pavarur të kryejë monitorim për këto lloj përmbajtjesh pa softuer të përshtatshëm. Blerja e një softueri të tillë është shumë e shtrenjtë, prandaj, pas konsultimit me disa kompani që ofrojnë shërbime të tilla dhe prezantimit për zgjidhjen e tyre, u arrit në përfundimin se është më ekonomike të shfrytëzohen softuerët ekzistues përmes një abonimi mujor. Në këtë drejtim, është propozuar që në vend të një investimi të njëhershëm, të sigurohet një kompensim mujor për shfrytëzim të shërbimit në periudhë prej gjashtë muajsh, në shumë totale prej 300.000,00 denarë. Trajçevski gjithashtu shpjegoi, sipas përvojës së deritanishme, përmes ankandi elektronik kjo shumë zakonisht zvogëlohet, megjithëse në mënyrë të parëndësishme, për shkak të të ashtuquajturit ankand negativ. Njëkohësisht, ai njoftoi se në seancën e ardhshme do të kryhet ndryshim i Planit për furnizim publik, ku do të bëhet njoftim publik për tre furnizimet e planifikuara, përfshirë edhe këtë. Procesi do të kryhet nga shërbimet e Agjencisë, të cilat do të zgjedhin operatorin më të përshtatshëm për realizimin e shërbimeve.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për miratimin e ribalancit të Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025, nr.05-1883/1 datë 25.04.2025.

Shpenzimet në total të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025 mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, përkatësisht arrijnë deri në 202.429.722,00 denarë.

Me ndryshimet e propozuara do të sigurohen mjete të destinuara për:

- sigurimi i të dhënave të marra përmes matjes elektronike, për shikueshmërinë e reklamave politike me pagesë me të dhëna të detajuara për transmetim të RPP (reklamave politike me pagesë) në televizionet tokësore kombëtare gjatë Zgjedhjeve Lokale në vitin 2025, në shumën prej 515.000,00 denarë;
- marrje e hapësirës për publikimin e njoftimeve në gazetatat ditore, në shumën prej 710.000,00 denarë, dhe
- sigurimin e qasjes në platformën për monitorim dhe përgatitjen e raporteve për mediat online – internet portale dhe rrjetet sociale me fokus tek influencuesit / vlogerët / krijuesit e përmbajtjeve dhe për publikime në lidhje me ASHMA-në për periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh, në shumën prej 300.000,00 denarësh.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit ALTRA-SAT 2000 SHPKNJP Ohër, për shkelje të nenit 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV). Ai shpjegoi se kjo masë duhej të ishte shqyrtuar në seancën e mëparshme, me përbërjen e mëparshme të Këshillit të ASHMA-së, por seanca nuk u mbajt sepse po atë ditë u zgjodh përbërja e re e Këshillit. Gjatë mbikëqyrjes, është

konstatuar se operatori kishte shkelur Ligjin, sepse ka transmetuar shërbim programor ("TV Kanal 5", "TV Alsat M", "Minimax" dhe "Balkanika") që nuk ishin paraqitur në çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia. Prandaj, propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike, meqenëse kjo është shkelja e parë për këtë vit, operatori do të njoftohet menjëherë që të ndërpresë me transmetimin e tre shërbimeve programore dhe më pas të kryhet monitorim për të kontrolluar nëse operatori ka përmbushur vendimin e Këshillit.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje e kryer të rregullt programore, nr.11-2615/1 datë 19.06.2025 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë tregtare për prodhimtari, tregti dhe shërbime ALTRA - SAT 2000 SHPKNJP Ohër t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141, paragrafi 13 të LSHMAAV, në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, dhe është urdhëruar që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e saj me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja u konstatua se Shoqëria Tregtare për prodhimtari, tregti dhe shërbime ALTRA - SAT 2000 SHPKNJP Ohër, e cila sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të kryejë(ushtrojë) veprimtari në territorin e Komunës së Ohrit, me datë 18.06.2025, për shfrytëzuesit e saj ritransmetoi shërbimet programore "TV Kanal 5", "TV Alsat M", "Minimax" dhe "Balkanika", të cilat nuk mbulohen nga çertifikata e regjistrimit të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, që është në kundërshtim me nenin 141 paragrafi 13 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit të lartpërmendur.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Z. Trajçevski shpjegoi se propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike për dy transmetues, SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP dhe SHTR TV studio TERA Mangovski Zoran Manastir SHPKNJP. Arsyeja është për shkak të shkeljes së nenit 50, paragrafi 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, si dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Nga mbikëqyrja u përcaktua që të dy stacionet kanë transmetuar programe të kategorisë së dytë, por shenja paralajmëruese nuk është shfaqur në në mënyrë të drejtë. Në fillim dhe gjatë transmetimit, mungon numri "8" dhe shenja "+", të cilat janë elementë të detyrueshëm për të shënuar kategorinë e grupmoshës së publikut. Propozohet vërejtje publike, pasi që kjo është shkelja e parë e këtij lloji në vitin 2025, dhe urdhërohet që në afat prej 20 ditësh pas pranimit të Aktvendimit ta harmonizojnë punën e saj me Ligjin dhe Rregulloren, dhe pas skadimit të afatit, Agjencia të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse transmetuesit kanë vepruar në pajtim me vërejtjen.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi se shkelja u përcaktua gjatë mbikëqyrjes së rregullt të kryer në maj 2025. Bëhet fjalë për aplikim të gabuar të sinjalit paralajmërues në programet e kategorisë së dytë. Sipas nenit 23 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë është i detyruar, para se të shqipton vërejtje publike, të kërkojë deklaram nga transmetuesi për shkeljen e konstatuar. Pas përgatitjes së Raportit dhe publikimit në ueb faqe, Agjencia kërkoj deklaram ofical nga transmetuesi. Transmetuesi u deklarua në afatin e caktuar dhe ajo deklarata është pjesë e materialit të dorëzuar në Këshill. Në shkresë, transmetuesi citoj se menjëherë ka vepruar sipas rekomandimeve në Raport dhe ka harmonizuar programin me dispozitat ligjore.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt programore, nr.10-2253/1 datë 29.05.2025 dhe njëzëri konkludoi ndaj SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50, paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, sepse më 2 maj 2025, disa programe u transmetuan duke shënuar gabimisht sinjalin paralajmërues për program të kategorisë së dytë. Në të gjithë pamjen e shënuar të sinjalistikës paralajmëruese në fillim dhe gjatë transmetimit mungon numri " 8" dhe shenja " + ", si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilët është destinuar programi.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Akvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimi e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV Studio TERA Mangovski Zoran Manastir SHPKNJP, për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Ai shpjegoi se kjo ishte e njëjta shkelje si tek transmetuesi në pikën e mëparshme. Nga mbikëqyrja u konstatua se gjatë transmetimit të dy programeve artistike, gabimisht është aplikuar sinjali paralajmërues për programe të kategorisë së dytë. Nga pamja e përshkruar e sinjalistikës mungon numri "8" dhe shenja "+", të cilat nuk tregonin qartë se programi ishte destinuar për publikun mbi 8 vjet.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt programore, nr.10-2247/1 datë 29.05.2025 dhe njëzëri konkludoi ndaj SHTR TV studio TERA Mangovski Zoran Manastir SHPKNJP, t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50, paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, sepse më 2 maj 2025, gjatë transmetimit të dy programeve artistike, është zbatuar gabimisht sinjali

paralajmërues për program të kategorisë së dytë. Në tërësinë e pamjes së përshkruar të sinjalistikës paralajmëruese mungon: numri " 8"; dhe shenja " + ", si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilët është destinuar programi.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhërua që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimi e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Spektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për realizimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit - "Ditët e Arsimimit Mediatik 2025". Ajo shpjegoi se ky furnizim publik është planifikuar në pajtim me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 dhe mjetet për furnizim sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2025. Procedura do të realizohet si procedurë e thjeshtë dhe e hapur, me njoftim publik që do të publikohet në Sistemin Elektronik për furnizim publik dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut . Ajo shtoi se të gjitha të dhënat shtesë përmbahen në materialet e dorëzuara sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Udhëheqësja e Spektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi se këtë vit për herë të shtatë do të mbahen Ditët e Arsimimit Mediatik, të cilat do të organizohen në gjysmën e dytë të nëntorit, menjëherë pas përfundimit të Zgjedhjeve Lokale. Ajo theksoi se tema e Ditëve çdo vit përputhet me aktivitetet e UNESCO-s për Javën Globale të Arsimimit Mediatik Informativ, dhe për vitin 2025 tema e përgjithshme është "Mendja para Inteligjencës Artificiale". Në kuadër të kësaj teme, disa anëtarë të Rrjetit për Arsimim Mediatik, të koordinuar nga Agjencia, do të organizojnë aktivitete të ndryshme. Nga operatori ekonomik që do të zgjidhet nëpërmjet furnizimi publik pritet të: hartojë fushatën dhe dizajnin e përgjithshëm; të prodhojë video dhe spote në radio, të krijojë njoftime për reklamim të rrjeteve sociale, të postojë publikime nga evente gjatë Ditëve të Arsimimit Mediatik, të organizojë së paku dy punëtori si pjesë e aktiviteteve të Agjencisë. Ajo theksoi se aktivitetet e tjera do të mbulohen nga vetë organizatorët, anëtarë të Rrjetit, ndërsa furnizimi do të sigurojë edhe materiale reklamuese për eventet. Ajo gjithashtu vuri në dukje se ngjarja e parë, e organizuar tradicionalisht nga Agjencia, këtë vit do të jetë një konferencë e madhe rajonale e organizuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Maqedoni. Me këtë event do të hapen Ditët e Arsimimit Mediatik dhe do të prezantohen aktivitetet që do të realizohen gjatë këtij eventi. Ajo shpjegoi se furnizimi bëhet paraprakisht për shkak të nevojës që operatori të ketë kohë të mjaftueshme për të hartuar të gjithë fushatën.

Z. Xhurovski kërkoi sqarim në lidhje me organizimin e Ditëve të Arsimit Mediatik.

Udhëheqësja Janevska shpjegoi se aktiviteti realizohet në kuadër të Javës Globale të Arsimit Mediatik Informativ të UNESCO-s, nga ku Agjencia e koordinon organizimin e Ditëve që të zhvillohen gjatë asaj periudhe. Ajo shtoi se më 27 prill 2017, me iniciativën e Agjencisë dhe 35 organizatave të tjera të shoqërisë civile, mediave, ministrive, institucioneve arsimore dhe subjekteve të tjera, u krijua Rrjet për Arsimit Mediatik. Aktualisht, rrjeti ka 87 anëtarë, nga të cilët 84 janë persona juridikë dhe 3 janë persona fizik. Nga këta, rreth 15 anëtarë janë më aktivë, kryesisht organizata të shoqërisë civile.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për realizimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Ditët e Arsimit Mediatik 2025.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: mbajtja e Ditëve të Arsimit Mediatik 2025, është planifikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

Pika 8

Znj. Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për Licencë Firewall. Shpjegoi se është e nevojshme të mirret leja për pajisje sigurie të rrjetit kompjuterik për të siguruar mbrojtjen e rrjetit kompjuterik në Agjenci. Ajo theksoi se për këtë furnizim janë përmbushur të gjitha parakushtet ligjore dhe se furnizimi është parashikuar në Planin për furnizim publik dhe Planin Financiar të Agjencisë. Sipas vlerës së parashikuar, furnizimi do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët, duke respektuar dispozitat e Ligjit për furnizim publik për këtë lloj procedure. Znj. Mitrevska informoi se procedura do të fillojë me publikimin e njoftimit në sistemin elektronik për furnizim publik dhe do të përfundojë me shfrytëzimin e ankandit elektronik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Drejtorin e Agjencisë për të kryer procedurë për furnizim publik - mallra: Licencë Firewall.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Licencë Firewall, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr. 05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjete janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

Pika 9

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimi: Çertifikata Digjitale. Ajo shpjegoi se furnizimi realizohet me qëllim zgjatjen e vlefshmërisë së çertifikatave digjitale ekzistuese dhe nevojën për dhënien e çertifikatave të reja digjitale për nënshkrim, të njohura si token. Ajo theksoi se furnizimi është parashikuar në Planin Financiar dhe Planin për furnizim publik të Agjencisë. Ajo informoi se procedura do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët, në përputhje me dispozitat ligjore, nëpërmjet publikimit

të njoftimi në sistemin elektronik për furnizim publik. Ajo theksoi se të gjitha të dhënat shtesë mbi furnizimin përmbahen në materialet e dorëzuara për seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për realizimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Çertifikata Digjitale.

Realizimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Çertifikata Digjitale, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr. 05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Pika 10

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për realizimin e procedurës për furnizim publik të shërbimi: Hulumtim – Analizë e çështjeve gjinore dhe mënyrës së prezantimit dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve. Ajo shpjegoi se përgatitja e këtij hulumtimi vjetor është detyrim ligjor i Agjencisë, në pajtim me Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave. Ajo theksoi se furnizimi do të kryhet si procedurë e thjeshtë dhe e hapur, sipas vlerës së parashikuar. Procedura do të fillojë me publikimin e njoftimit në sistemin elektronik për furnizim publik dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për realizimin e procedurës për furnizim publik shërbim: Hulumtim - Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e prezantimit dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve.

Realizimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Hulumtim – Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyrës së prezantimit dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr. 05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Pika 11

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,**

Mr. Sasho STEFANOVSKI